



JAN 2021



TITUJT

Editorial: përparësitë për vitin 2021 [page 1](#)

KOVID-19: Aktivitetet e përgjigjes dhe rimëkëmbjes nga KOVID-19 [page 2](#)

PROGRAME TË PËRBASHKËTA [page 3](#)

Në fokus: Përgatitja për vaksinat për KOVID-19 [page 4](#)

NGJARJET MË TË RËNDËSISHME

DHJETOR

- 11** Eveniment për konsultimit publik në kuadër të projektit të mbështetur nga GEF mbi Raportin e gjashtë nacional të Konventës për Diversitetin Biologjik.
- 16** Eveniment përmblyës për tre aktivitetet e projektit GEF5: zhvillimi i hartave të para të bimëve pyjore për rajonin e Maleshevs; Harta e re nacionale e pikave të ndjeshme ndaj erozionit dhe thatësisë; dhe zhvillimi i një baze të të dhënave për shkallën e vullstjes së tokës dhe humbjen e lëndës organike në tre pilot rajone - në rajonin e Strumicës, Përlepit dhe atë të Ohrit.
- 18** Punëtorja interaktive mbi nevojat e paraqitura si rezultat i ndryshimeve klimatike e organizuar nga FAO dhe Kabineti i Zëvendëskryeministrit, përgjegjës për çështje ekonomike, si Autoritet Përgjegjës Nacional (APN) për Fondin e Klimës së Gjelbër (GCF)
- 18** AO dhe APN për GCF filluan një sondazh në internet për të mbledhur të dhëna mbi njohuritë, interesin dhe vullnetin e sektorit privat për financimin e projekteve që kanë të bëjnë me klimën dhe për ta ndihmuar Qeverinë që të angazhohet me sektorin privat për t'i zhvilluar/vënë në dispozicion instrumentet e financimit të klimës dhe për t'i mobilizuar investimet e sektorit privat për klimën.
- 23** Konsultim me palët përkatëse të projekt Studimit mbi rivalorizimin e monumentit natyror – Liqenit të Ohrit.
- 28** Punëtorja fillestare e projektit të FAO-s "Mbështetja e zhvillimit të tregjeve të tokave bujqësore për përfshirje në prodhim të tokës së braktisur"

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Më lejoni që me kalimin në vitin e ri, të bëjmë një pasqyrim të mënyrës sesi prioritetet globale të Sistemit për Zhvillim të OKB-së ngelin drejtpërsëdrejti relevante për OKB-në në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021.

Më 1 janar u shënuar fillimi i ciklit të ri të programimit të Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB (KBZhQ) 2021-2025, dokumenti kryesor i planifikimit strategjik të OKB-së për vendin. Gjatë vitit 2020 jemi përkushtuar me vëmendje dhe burime të konsiderueshme për t'u konsultuar me një spektër të gjerë të palëve të interesuara për prioritetet kryesore të identitetit, të cilat do t'i drejtojnë përpjekjet dhe burimet kolektive të OKB në sferat e Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm (QZhQ), në lidhje me prosperitetin dhe njerëzit, planetin dhe paqen, me fokus të veçantë në grupet më të prekshme dhe ata që rrezikojnë të neglizhohen.

Përdërisa vazhdojmë t'i transformojmë planet në veprim dhe në zhvillim të politikave të shëndosha në 2021 dhe më tej, fokusi i OKB-së do të mbetet të sigurojmë që puna jonë të jetë plotësisht e mbështetur në prova, analizat më aktuale dhe të dhënat e besueshme, të shoqëruara me mbështetjen për një koordinim të përmirësuar dhe shkëmbimin e informacioneve në të gjitha nivelet. Regjistrimi mbarëkombëtar është thelbësor për këtë dhe do të kishte një ndikim afatgjatë në politikat zhvillimore të vendit. Duhet të vazhdojmë përpjekjet nga të gjithë palët e interesuar për të mbështetur dhe kërkuar konsensus për këtë operacion të rëndësishëm statistikor dhe për ta parandaluar politizimin e tij.

Në vitin 2021, OKB-ja në Maqedoninë e Veriut do të vazhdojë të ofrojë mbështetje analitike, politike dhe operacionale për kundërpërgjigjen dhe rikuperim nga pasojat e KOVID-19. Meqenëse është bërë shumë për ta analizuar ndikimin e tij socio-ekonomik, duke qenë gati një vit në krizë, është me rëndësi thelbësore të vazhdohet me vlerësimin e ndikimit të pandemisë, dobësitë ekzistuese dhe ato të reja në kohë reale, duke u përqendruar në grupet më të prekura, si dhe të përdoren këto njohuri për ta mbështetur rikuperimin më të shpejtë dhe më të mirë.

Digjitalizimi, rikuperimi i gjelbër, mbështetja anekënd shoqërisë për sistemet e fuqizuara të shëndetit dhe mbështetjes sociale janë vetëm disa nga mundësitë që vijnë me KOVID-19, të cilat ne bashkërisht mund t'i ofrojmë, por edhe do të vazhdojmë të

investojmë në burimet dhe përpjekjet tona në vitin 2021. Kjo do të jetë në rend të parë të mbështetjes së vazhdueshme për aktivitetet e vijës së parë në luftën e përbashkët kundër pandemisë. Një



përparësi e tillë e menjëhershme është mbështetja e Qeverisë për shpërndarjen efikase të vaksinave KOVID-19 të siguruar përmes mekanizmit COVAX (Mekanizmi global për qasje në vaksina për KOVID-19) dhe kanaleve të tjera. Vështirësitë logjistike, furnizimi i kufizuar dhe hezitimi në lidhje me vaksinat janë vetëm disa nga sfidat, që duhet të adresohen shpejt dhe me efikasitet, me qëllim të përmbyesjes së rrjedhës së pandemisë globale.

Në vitin 2020 Sistemi i OKB-së për Zhvillim ka ofruar një nxitje të konsiderueshme për përgjigje kundër pandemisë. Ne ishim në pozitë më të mirë për ta bërë këtë edhe për shkak të reformës së vazhdueshme të Sistemit të OKB-së për Zhvillim, i cili ka për qëllim të sigurojë një OKB më efikase dhe koherente që vepron dhe flet njëzëshëm.

Pasi po fillojmë me vitin e dytë të Dekadës së Veprimit drejt Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (vizioni ynë i përbashkët për t'i dhënë fund varfërisë, për ta mbrojtur planetin tonë të brishtë dhe për të ndërtuar një botë paqësore) koordinatorëve të përhershëm të OKB-së në mbarë botën u është kërkuar të mësojnë dhe të ndërtojnë ide nga përvojat me krizën e shkaktuar nga KOVID-19, gjegjësisht të punojnë drejt përshejtit të punës sonë të përbashkët drejtuar veprimeve klimatike dhe mjedisore.

Në vitin 2021 së bashku do t'i përdorim burimet dhe pikat tona të forta për ta përshpejtuar mbështetjen për agjendën e klimës, një përparësi kryesore e zhvillimit të qëndrueshëm për Maqedoninë e Veriut.

Rosana Duxhak
Koordinator i përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut

AKTIVITETET E PËRGGJIGJES DHE RIMËKËMBJES NGA KOVID-19

Subjektet e OKB-së vazhdojnë t'i mbështesin masat në vend kundër KOVID-19 me analiza specifike dhe të hollësishme të përqendruara në çështje brenda fushave të tyre përkatëse të ekspertizës.

Analiza socio-ekonomike e **Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)** e kryer në vitin 2020 mbuloi tre lloje të analizave – atë makroekonomike, sektoriale dhe të bazuar në komuna. Analiza makroekonomike nxori në pah dëmet e shkaktuara ndaj ekonomisë nacionale nga KOVID-19, që kanë ushtruar presion të madh mbi nivelin e papunësisë dhe varfërisë dhe i kanë përmbysur fitimet dhe rezultatet e zhvillimit para krizës. Pandemia ka të ngjarë të shkaktojë një ulje vjetore të BPV-së prej 4%, ndërsa ekonomia nuk pritet të kthehet “në normalitet” para fundit të vitit 2023. Papunësia ishte parashikuar të kalonte 20% në fund të vitit 2020, duke çuar në 21% rritjen e shkallës së varfërisë. Të ardhurat e buxhetit kanë rënë për rreth 400 milion € në të gjitha kategoritë, gjë që ka bërë të rritet borxhi dhe deficitet përtej atyre të shënuara gjatë krizës globale financiare nga viti 2009. Kjo do të ndikojë në alokimin e përgjithshëm të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për komunat në 2021, e cila pritet të ulët për 7.8%.

Kriza ka pasur një ndikim të rëndë në industri. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 është regjistruar rënie prej 14.6% në prodhimin industrial, 33.3% rënie në qarkullimin e tregtisë me shumicë dhe 8.9% në tregtinë me pakicë. Industritë më të goditura ishin turizmi dhe hotelieria, pasi bujtja gjatë natës kishte rënë për 66%, përkatësisht 97.8% për turistët e vendit dhe të huaj gjatë pesë muajve të parë të vitit 2020. Disa sektorë të industrisë janë provuar të rezistueshëm ndaj krizës dhe kanë shënuar rritje. Ato janë farmaceutika, industria kompjuterike, elektronike dhe ndërtimtaria, mirëpo degët e tjera industriale, të cilat përbëjnë deri në 86% të prodhimit industrial, u ndikuan negativisht nga pandemia e KOVID-19.

Të dhënat socio-ekonomike do të azhurohen rregullisht për ta ndjekur dinamikën e rimëkëmbjes ekonomike me detaje të disponueshme në platformën e mbështetur nga UNDP.

www.impact-covid19.mk

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) kreu rinovimin e blloqeve të ujësjellësit, higjienës dhe ambienteve sanitare (WASH) në qendrën e përkohshme të transitit “Vinojug” në Gjevgjeli në përputhje me protokollet e mbrojtjes nga

KOVID-19. Përmes kësaj ndërhyrjeje, IOM i ka rinovuar blloqet (WASH) dhe ka instaluar pika për larje të duarve para njësisë individuale të akomodimit. Ky rinovim është pjesë e projektit rajonal të financuar nga Bashkimi Evropian “Adresimi i Sfidave të KOVID-19 për Përgjigje ndaj Migrantëve dhe Refugjatëve në Ballkanin Perëndimor”, që i mbështet protagonistët kryesorë të menaxhimit të migracionit dhe azilit në rajon, për t'i adresuar sfidat e shkaktuara nga pandemia dhe për t'i mirëmbajtur të gjitha shërbimet e nevojshme.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Këshilli Nacional Ekonomik dhe Social filluan zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit të bazuar në internet. Platforma në internet Puna lme, Të drejtat e Mia! www.mojtrudmoiprava.mk mundëson qasje në kohë reale në informacionet për punëtorët dhe punëdhënësit; ajo përmban informacione mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin nga marrëdhëniet e punës në kategoritë e mëposhtme: kontrata e punës, rroga, orari i punës, pushimi, siguria dhe shëndeti në punë, diskriminimi, mobingu, sigurimet shoqërore dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Për më shumë informacion shihni

• Ueb faqen www.mojtrudmoiprava.mk

• Faqen e Fejsbukut <https://www.facebook.com/mojtrudmoiprava>

• Videot https://www.youtube.com/channel/UCU2Ua19qJcH_E5_6_rpyuwQ

e kapaciteteve që kanë të bëjnë me veprimin dhe financimin e klimës për ta mbështetur përmeshjen e Kontributeve të Përcaktuara Nacionale në vend dhe angazhimin me GCF. Për më tepër, FAO ka punuar me Qeverinë për t'i vënë në pah protagonistët e sektorit privat në Maqedoninë e Veriut dhe për t'i ndihmuar ata t'i shfrytëzojnë plotësisht mundësitë për investime transformuese në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe me karbon të ulët, që gjithashtu mund të shpijë në efikasitet të përfutur. Për ta lehtësuar ndërveprimin me sektorin privat në kontekstin e financimit të klimës, FAO dhe Autoriteti i Përcaktuar Nacional (APN) kanë filluar aktivitete, të cilat synojnë nxitjen dhe fuqizimin e interesit të sektorit privat dhe angazhimin në financimin e klimës, përfshirë edhe burime të tilla siç është GCF.

Duke synuar lehtësimin e qasjes së drejtpërdrejtë në burimet e GCF-së, një thirrje e hapur për shprehjen e interesit të GCF-ve të mundshme për qasjes të drejtpërdrejtë në Maqedoninë e Veriut filloi në nëntor të vitit 2020 dhe përfundoi më 31 dhjetor të vitit 2020. Disa aplikacione janë dorëzuar nga institucione publike dhe private të interesuara, për t'u konsideruar për akreditim me GCF. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, FAO, në bashkëpunim të ngushtë me APN-në, do t'i vlerësojë aplikuesit sipas një sistemi dakorduar të dhënies së pikëve, me qëllim që ta lehtësojë një proces transparent të përzgjedhjes së subjekteve potenciale për t'u nënshtruar procesit të akreditimit për GCF.

AKTIVITETE TJERA


Pesëmbëdhjetë gazetarë nga media të ndryshme nacionale dhe lokale të lajmeve morën pjesë në një trajnim katër ditor mbi “Mbulimin mediatik të procesit të integritetit në BE”. Trajnimi, i organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) në koordinim me Sekretariatën për Çështjet Evropiane (SÇE), synon ta forcojë kapacitetin e mediave për krijimin e përmbajtjes në lidhje me procesin e negociatave me BE-në, që në këtë mënyrë të kontribuojë përmes transparencës së shtuar të vetë procesit. Përmbajtja dhe diskutimet nga trajnimi do të përdoren për ta përgatitur një Manual të Raportimit të Mediave mbi Procesin e Negocimit të BE-së. UNOPS-i gjithashtu ka punuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme në realizimin e një trajnimi për diplomatët në fushën e Kapitullit 27 mbi mjedisin jetësor, me qëllim që t'i njoftojë diplomatët profesionistë me tendencat aktuale në diplomacinë e gjelbër dhe t'i mbështesë ata në përgatitjen e adresimit të sfidave në zbatimin e politikave mjedisore të BE-së.

Në kuadër të Projektit për Gatishmëri të Fondit të Dytë për Klimë të Gjelbër (GCF) në Maqedoninë e Veriut, **Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO)** synon ta mbështesë Qeverinë në forcimin e kapaciteteve nacionale për veprim klimatik dhe finalizimin e Programit të Punës në Vend për GCF. Si hap i parë në këtë proces, FAO ka realizuar aktivitete për t'i identifikuar dhe vlerësuar nevojat

LATEST EPIDEMIOLOGICAL DATA (8 Feb 2021)

94,798 CONFIRMED COVID-19 CASES	2,924 COVID-19-RELATED FATALITIES
45,502 CONFIRMED CASES PER 1,000,000 PEOPLE	1,403 FATALITIES PER 1,000,000 PEOPLE

Daily new cases reported



For latest data see covid19.who.int/region/euro/country/mk

PROGRAME TË PËRBASHKËTA

Pse programe të përbashkëta?

Program i përbashkët paraqet një modalitet të zbatimit të projektit, i cili mundëson që shumë njësi të OKB-së të punojnë së bashku për një çështje apo temë specifike. Përmes programeve të përbashkëta, vendi dhe popullsia e tij përfitojnë nga ekspertiza e kombinuar e sistemit të OKB-së për një temë të caktuar, duke sjellë një zgjidhje shumëdimensionale dhe gjithëpërfshirëse për problemet komplekse. Projektet e përbashkëta gjithashtu u mundësojnë njësitë ekonomike të punojnë dhe veprojnë si një OKB, duke e vënë në zbatim Reformën e Sistemit të OKB-së për Zhvillim. Veç kësaj, programet e përbashkëta gjithashtu i rrisin mundësitë e mobilizimit të burimeve pasi ato mundësojnë qasje në struktura dhe ekspertiza të shumfështa të financimit global.

Nga viti 2020, ekipi shtetëror i OKB-së në Maqedoninë e Veriut ka vënë në fokus të shtuar zgjerimin e portofolit të programeve të përbashkëta. Në këtë drejtim janë zhvilluar koncepte dhe zgjidhje të reja, të cilat kanë tërhequr financim të ri, duke përfshirë programe të reja, që presin vendime financiare në tremujorin e parë të vitit 2021.

“Planifikimi dhe diskursi i politikës së migracionit të bazuar në dëshmi”

Ky [program i përbashkët](#), i cili ka filluar në fund të vitit 2020, synon t'i mbështesë institucionet nacionale në përmirësimin e menaxhimit të dinamikës demografike dhe migracionit në vend. Programi siguron mbështetje në tre fusha kryesore të migracionit: në zhvillimin e një politike të migrimi drejt të ardhshëm dhe të bazuar në prova, në fuqizimin e qasjes në të dhëna për migracionin, si dhe në ndikimin e narrativit mbi migrantët dhe refugjatët si protagonistë pozitivë të zhvillimit në shoqëri. Pra programi do të sigurojë mbështetje të fuqishme: në mbledhjen e të dhënave, përmes fuqizimit të

PROGRAMME DETAILS

Duration: October 2020 - April 2023
Budget: \$1,500,000

Key national partners: Ministry of Interior, State Statistical Office, Ministry of Labour and Social Policy, Ministry of Information Society and Public Administration, National Bank of the Republic of North Macedonia, Ministry of Foreign Affairs, Secretariat for European Affairs, Macedonian Young Lawyers Association, Macedonian Anti-Poverty Platform and the European Policy Institute.

Key beneficiaries: general public, media representatives, policy makers, institutional stakeholders, migrants.

Financed by: Migration Multi-Partner Trust Fund

Implemented by:



shkëmbimit ndërinstytucional të të dhënave për migracionin; zhvillimin e profilit të migracionit në vend; Indeksit e Menaxhimit të Migracionit; përfshirjen e modulit të migrimit në anketën e forcës së punës dhe gjenerimin e të dhënave të reja të migracionit të bazuara në metodat inovative të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë pilotimin e analizës së të dhënave të mëdha. Një aspekt i fortë i projektit është qasja e tij holistike për gjithë qeverinë, gjithë shoqërinë, me disa ministri, institucione shtetërore dhe organizata të shoqërisë civile (OSHC) të përfshira në hartimin dhe zbatimin e tij. OKB-ja është duke bërë tok ekspertizën e tre njësitë të saj – IOM-in, Komisionarin e Lartë i OKB për Refugjatët

(UNHCR) dhe Fondin e OKB mbi Popullsinë (UNFPA). Programi financohet nga [Start-up-i Fondi për migracionin të sigurt, adekuat dhe të rregullt](#). Ndër kontribuuesit kryesor të tanishëm të këtij programi janë Danimarka, Gjermania, Norvegjia, Portugalia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar (MB).

“Puna nga poshtë lart - ndërtimi i një modeli lokal për deinstitutionalizimin”

Ky [program i përbashkët](#), i implementuar në periudhën qershor 2018 dhe dhjetor 2020, të fokusuar në pilotimin e modeleve për shërbime dhe deinstitutionalizim të lehtë, me fokus specifik gjeografik për banuesit e institucionit të Banja Banskos në rajonin e Strumicës. Puna e njëjës pjesëmarrëse të OKB-së - Fondi i OKB-së për Fëmijëve (UNICEF), UNDP, UN Women dhe UNFPA – ka arritur një kontribut të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të agjendës nacionale të deinstitutionalizimit përmes përpjekjeve shumë-sektoriale. Duke ndërtuar një model të nivelit të komunitetit, ekipi i

PROGRAMME DETAILS

Duration: June 2018 – December 2020
Budget: \$400,000

Key national partners: Ministry of Labour and Social Policy, Ministry of Education and Science, Ministry of Health, Local Self Government, Institute of Social Activities, State Education Inspectorate, Center for Social Work, regional Employment Centers, CSOs, academia, Ombudsman.

Key beneficiaries: children and adults with disabilities, public institutions, civil society organizations, disabled persons' organizations, schools, state education inspectors, foster care parents, families, prospective foster parents.

Financed by: UNPRPD

Implemented by:



OKB-së ka demonstruar se si të ndërtohen ura për punësim të personave me aftësi të kufizuara: si të sigurohet arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara: si të përforcohen modelet të përkujdesit shoqëror dhe familjar alternativ, të bazuar në komunitet; dhe si të sigurohen shërbime të shëndetit seksual dhe riprodhues për gratë me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrja e plotë e personave me aftësi të kufizuara gjatë gjithë procesit të projektit ka ndihmuar në identifikimin e ngërceve dhe fuqizimin e individëve për të luajtur rol aktiv. Përmes këtij veprimi, ekipi i OKB-së vërtetoi që opsionet e bazuara në komunitet janë një mënyrë e mundshme dhe e përballueshme për ta lehtësuar jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara dhe për zhvillim të modeleve të shërbimeve për zbatim më të gjerë. Ky program është financuar nga [Fondi Multi-donor Trust \(MPTF\) të Partneritetit të OKB-së për promovim të të drejtave të personave me paaftësi \(UN-PPDPP\)](#). Ndër kontribuuesit kryesor të programit përfshihen Austria, Finlanda, Norvegjia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

“Shërbime shëndetësore të sigurt dhe inovative gjatë Covid-19 në Maqedoninë e Veriut”

Sigurimi i shëndetit seksual dhe riprodhues, imunizimi dhe

shërbimet e mbështetjes nga dhuna me bazë gjinore janë ulur në mënyrë dramatike që nga shpërthimi i COVID-19. Synimi i këtij projekti të përbashkët - i zbatuar nga UNFPA-ja, UNICEF-i dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) - është ta përmirësojë qasjen në këto shërbime për gratë, vajzat adoleshente dhe fëmijët, me një fokus të veçantë në popullatën më të prekshme në zonat e largëta dhe me më pak shërbime. Projekti përfshin shërbime inovative shëndetësore të ofruara nga ekipet mjekësore në klinikat

PROGRAMME DETAILS

Duration: January 2021 – March 2022
Budget: \$850,000

Key national partners: Ministry of Health, Ministry of Labour and Social Policy, E-Health Directorate, Association of Gynecologists and Obstetricians, Committee on Safe Motherhood and Healthy Newborn, Macedonian Medical Association, Macedonian Association of Nurses and Midwives, University Clinic of Psychiatry and civil society organizations.

Key beneficiaries: women and children in remote areas, health care workers, whole population.

Financed by:

UN COVID-19 RESPONSE AND RECOVERY MULTI-PARTNER TRUST FUND

Implemented by:



mobile gjinekologjike, që synojnë ta përmirësojnë qasjen në shërbimet gjinekologjike/obstetrike dhe fuqizojnë referimin dhe mbështetjen e integruar ndaj dhunës me bazë gjinore në zonat e thella, duke e përmirësuar mbulimin e imunizimit dhe mbledhjen e të dhënave përmes përfshirjes së regjistrit digital të e-imunizimit; dhe rrezikon në lidhje komunikimin me popullatën skeptike ndaj imunizimit. Këto shërbime të ofrimit të tyre që nga shpërthimi i COVID-19 dhe do të mundësojnë administrim më efikas dhe politika relevante mbi të dhënat në kohë reale për imunizimin, si dhe mbështetje më të madhe publike për vaksinimin. Projekti është financuar nga [Fondi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për përgjigje dhe rikuperim nga Covid-19](#); kontribuuesit kryesor të tij janë Austria, Danimarka, Republika e Koresë, Holanda, Norvegjia, Suedia dhe Zvicra.

Përtej këtyre tre programeve, Zyra e OKB-së në Maqedoninë e Veriut është duke e përgatitur një program të ri të përbashkët për barazinë dhe përfshirjen e personave me paaftësi përmes reformave sistematike, të cilat janë objekt i aprovimit financiar të [UN-PRPD MPTF](#); dhe në pritje të vendimit përfundimtar të financimit për programin e përbashkët të Fondit të Përbashkët QZHQ për financim të gjelbër, që synon të përmirësojë ndjeshëm mundësinë e financimit të përballueshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe individët/familjet për investime në energji të rinovueshme dhe zgjidhje të efikasitetit të energjisë si dhe nxitjen e inovacionit në këto sektorët. Rezultatet e arritura përmes këtyre dhe iniciativave të tjera të përbashkëta të OKB do të vazhdojnë të ndahen përmes këtij Buletini dhe kanaleve tjera.

Në fokus përgatitja për vaksinat për COVID-19

Përgatitja për vaksinat për COVID-19

Vaksinat për COVID-19 janë mjete kritike për të ndihmuar në vënien nën kontroll të pandemisë, kuptohet në kombinim me testimet efektive dhe masat ekzistuese të parandalimit. Ka disa kandidatë premtes të vaksinave në rrjedhë e sipër, ndërsa disa janë nën shqyrtim për përdorim emergjent. Vaksinat Pfizer/ BioNTech, Moderna dhe Oxford-AstraZeneca janë miratuar tashmë për përdorim nga disa organe rregullatore të rrepta rajonale dhe nacionale, kështu që gara për një vaksinë të sigurt dhe efektive ka hyrë në një fazë të re. Ky azhurnim synon të japë përgjigje për disa nga pyetjet e ngutshme që kanë të bëjnë me vaksinën COVID-19.

Si zhvillohen vaksinat COVID-19?

Vaksinat funksionojnë duke imituar një agjent infektiv - viruse, baktere ose mikroorganizma tjerë, që mund të shkaktojnë sëmundje. Kjo "e mëson" sistemin tonë imunitar të përgjigjet me shpejtësi dhe në mënyrë efektive kundër këtyre mikroorganizmave.

Tradicionalisht, vaksinat e kanë bërë këtë veprim, duke e prezantuar një formë të dobësuar të një agjenti infektiv që lejon sistemin tonë imunitar të ndërtojë një memorie për të. Në këtë mënyrë, sistemi ynë imunitar mund ta njohë dhe luftojë shpejt përpara se të na bëjë të sëmurë. Kjo është mënyra se si po përgatiten disa kandidatë aktualë të vaksinave COVID-19.

Vaksinat e tjera të mundshme që përdorin qasje të reja dhe po zhvillohen, zakonisht referohen si vakcina ADN (acidi dezoksiribonukleik) dhe ARN (acidi ribonukleik). Në vend që të fusin antigjene (një substancë që bën që sistemi ynë imunitar të prodhojë antitropa), vaksinat e ARN-së dhe ADN-së e nxisin trupin tonë të gjenerojë një proteinë që vetë në mënyrë të sigurt shkaktin një përgjigje imune. Më shumë informacione mbi zhvillimin e vaksinës COVID-19 mund të gjenden në ueb faqen e [OBSH-së](#) dhe në ueb faqen e [Koalicionit për Inovacione të Gatishmërisë Epidemike \(CEPI\)](#).

Cilat janë dobiet e marrjes së vaksinës COVID-19?

COVID-19 transmetohet lehtësisht dhe mund të çojë në sëmundje serioze dhe vdekje, madje edhe për njerëzit që janë të rinj dhe të shëndetshëm. Vaksinat kundër COVID-19 do të aprovohen për përdorim në Maqedoninë e Veriut vetëm nëse studime të shumta, të rrepta dhe të hollësishme shkencore do të tregojnë se ato i ulin në mënyrë të sigurt rreziqet e infektimit me COVID-19. Ato do ta arrinin këtë, duke e përgatitur mbrojtjen natyrore të trupit tonë - sistemin imunitar - për ta njohur dhe luftuar virusin, që shkaktin COVID-19.

Shkencëtarët po studiojnë nëse njerëzit që vaksinohen për COVID-19 do të kishin më pak gjasa ta përcjellin virusin COVID-19 te njerëzit e tjerë. Nëse është kështu, vaksinimi mund të jetë një mënyrë e fuqishme jo vetëm për ta mbrojtur veten, por edhe gjithë komunitetin tonë.

A do të ofrojnë vaksinat COVID-19 mbrojtje afatgjate?

Është shumë herët të dihet nëse vaksinat COVID-19 do të sigurojnë mbrojtje afatgjatë, andaj do të nevojiten kërkime



Vaccine preparation. Photo credit @UNICEF/2020/Georgiev

shtesë për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Sidoqoftë, është inkurajuese që të dhënat e disponueshme sugjerojnë që shumica e njerëzve që shërohen nga COVID-19 zhvillojnë një përgjigje imune, që siguron të paktën një mbrojtje kundër infektimit të serishëm – ndonëse ne ende jemi duke mësuar se sa e fortë është kjo mbrojtje dhe sa zgjat ajo.

Sa shpejt do të mund vaksinat COVID-19 ta vënë në kontroll pandeminë?

Ne nuk e dimë saktësisht se sa shpejt vaksinat COVID-19 mund ta vënë nën kontroll pandeminë. Kjo do të varet nga shumë faktorë, siç është niveli i efektivitetit të vaksinës; sa shpejt aprovohen dhe prodhohen ato; sa njerëz vaksinohen; si dhe vazhdimi i masave siç janë distanca fizike dhe përdorimi i maskave.

Nëse merrni një vaksinë COVID-19, a do të duhet përsëri të ndërmerri masa të kujdesit, siç është distanca fizike?

Po. Tani për tani rekomandohet që të gjithë - përfshirë ata që janë vaksinuar - të vazhdojnë t'i përdorin të gjitha mjetet në dispozicion për ta ndaluar përhapjen e COVID-19, të tilla si distancimi fizik dhe përdorimi i maskave. Përdorimi i të gjitha këtyre mjeteve në kombinim do të sigurojë mbrojtje më të mirë të mundshme kundër marrjes dhe përhapjes së COVID-19. Ky rekomandim mund të ndryshojë në të ardhmen pasi të vaksinohen shumë njerëz dhe të mësojmë më shumë rreth mbrojtjes së "botës reale" të mundësuar nga vaksinat COVID-19.

Përgatitur nga UNICEF

QUICK LINKS

SCIENCE
in 5

Mite the fakte lidhur me Kovid-19

Dr. Kejt O Brajan nga OBSH i thyen disa prej miteve më të shpeshta lidhur me infertilitetin, ADN-në dhe përbërjen e vaksinave.

Llojet e ndryshme të vaksinave Kovid-19

Përse ka aq shumë vakcina në zhvillim dhe cilat janë llojet e ndryshme të vaksinave?

Source WHO

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 8 February 2021.

www.un.mk